

L I G J
Nr.8328, datë 16.4.1998

PËR TË DREJTAT DHE TRAJTIMIN E TË DËNUARVE ME BURGIM

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e Këshillit të Ministrave

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

PJESA E PARË
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

KREU I
OBJEKTI

Neni 1

Ky ligj përcakton të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim, kompetencat dhe detyrat e organeve shtetërore kompetente.

Neni 2

I nënshtrohen rregullave të këtij ligji të gjithë të dënuarit me burgim me vendim të formës së prerë të gjykatave shqiptare dhe në përputhje me marrëveshjet ndërkombëtare edhe të gjykatave të huaja, duke respektuar kërkesat përkatëse procedurale.

Neni 3

Në raste të veçanta, me kërkesë të organit kompetent dhe me urdhër të ministrit të Drejtësisë, mund të vendosen në institucionet që i nënshtrohen këtij ligji edhe persona të ndaluar ose të arrestuar ndaj të cilëve zbatohen kërkesat e Kodit të Procedurës Penale, si dhe ky ligj, për aq sa nuk vjen në kundërshtim me këtë Kod.

Neni 4

Vuajtja e dënimeve me burgim bëhet vetëm në vendet e caktuara posaçërisht sipas këtij ligji. Ministri i Drejtësisë në raste të gjendjes së jashtëzakonshme, të rrezikimit nga forca madhore, të kryerjes së punimeve të rëndësishme, si dhe kur rrezikohet jeta dhe shëndeti i të dënuarve, mund të urdhërojë që vuajtja e dënimit të bëhet përkohësisht në vende të tjera të përshtatshme.

KREU II
PARIMET THEMELORE

Neni 5

Respektimi i të drejtave të njeriut

Ekzekutimi i dënimit me burgim bëhet duke respektuar dinjitetin e të dënuarit dhe përshkohet nga ndjenja njerëzore.

Trajtimi i të dënuarve bëhet pa njëanshmëri apo diskriminim për shkak të seksit, kombësisë, racës, gjendjes ekonomike dhe shoqërore, pikëpamjeve politike dhe besimit fetar.

Të dënuarve duhet t’u sigurohen kushte jetese të tilla që ulin në minimum efektet

paragjyktuese negative të burgimit dhe ndryshimet me jetën e shtetasve të tjerë.

Neni 6

Kufizimi individual i të drejtave

Të drejtat e të dënuarve, sipas këtij ligji, mund të kufizohen ose të hiqen përkohësisht për shkelje të ligjit ose rregullave të brendshme, vetëm në rastet dhe sipas kritereve të parashikuara në këtë ligj.

Neni 7

Kufizimi në grup i të drejtave

Të drejtat e të dënuarve mund të kufizohen ose të hiqen përkohësisht në grup, me urdhër të ministrit të Drejtësisë vetëm në kushtet e gjendjes së jashtëzakonshme, për shkak të forcës madhore, të kryerjes së punimeve të rëndësishme në institucion ose kur ka rrezik për jetën dhe shëndetin e të dënuarve në atë masë dhe për aq kohë sa përcaktohet në urdhër.

Drejtuesi i institucionit dhe në mungesë të tij zëvendësi, për rastet urgjente mund të vendosin kufizime sipas paragrafit të parë të këtij neni dhe jo më vonë se 24 orë të marrë për këtë miratimin e Ministrit të Drejtësisë.

Neni 8

E drejta e kërkesës dhe ankimit

Të dënuarit kanë të drejtë të paraqesin kërkesa dhe të bëjnë ankime lidhur me zbatimin e ligjit dhe rregullave të brendshme në formën që përcaktohet në këtë ligj dhe në mënyrë individuale.

Kërkesat dhe ankesat duhet t'i drejtohen, si rregull, organit kompetent sipas këtij ligji, por të dënuarit kur e çmojnë me vend mund t'i drejtohen cilitdo organ shtetëror ose organizatë joqeveritare brenda dhe jashtë vendit.

Nuk lejohet paraqitja e kërkesave dhe ankesave në mënyrë kolektive ose veprime për shkak të tyre në formë të organizuar.

KREU III TRAJTIMI

Neni 9

Qëllimi riedukues

Për të dënuarit duhet të realizohet një trajtim që synon riedukimin për integrimin e tyre në jetën shoqërore.

Neni 10

Individualizimi i trajtimit

Trajtimi i të dënuarve duhet të bëhet sipas kriterit të individualizimit në përputhje me gjendjen dhe karakteristikat individuale të secilit të dënuar.

Individualizimi bëhet duke verifikuar nevojat individuale dhe duke marrë parasysh kushtet dhe mjedisin në të cilin i dënuari ka jetuar, shkaqet edukative dhe shoqërore që e kanë larguar atë nga jeta normale.

Vëzhgimi bëhet në fillim të trajtimit dhe rezultatet e tij verifikohen vazhdimisht gjatë ekzekutimit, duke bërë përshtatjet e duhura.

Neni 11

Programi dhe realizimi i trajtimit

Vëzhgimi, programimi dhe realizimi i trajtimit bëhet nga administrata e burgut me anë të

personelit të vet, në bashkëpunim me organet dhe institucionet shtetërore përkatëse.

Kontributi i organizatave joqeveritare dhe individëve të veçantë, inkurajohet dhe mbështetet nga administrata e burgjeve në realizimin e programit të trajtimit.

PJESA E DYTË INSTITUCIONET

KREU I LLOJET E INSTITUCIONEVE

Neni 12

Institucionet e ekzekutimit të dënimeve penale

Institucionet e ekzekutimit të vendimeve me burgim janë:

Burgu i sigurisë së lartë

Burgu i zakonshëm

Burgu i sigurisë së ulët

Institute të veçanta

Krijimi, kategorizimi, mbyllja e institucioneve të ekzekutimit të vendimeve me burgim bëhet me vendim të Ministrit të Drejtësisë.

Neni 13

Burgu i sigurisë së lartë

Burgu i sigurisë së lartë është institucioni ku ekzekutohen vendimet me burgim për subjekte të krimit të organizuar dhe të dënuar të tjerë të cilët në kryerjen e veprës penale ose gjatë vuajtjes së dënimit janë karakterizuar nga qëndrime e sjellje që bëjnë të pamundur qëndrimin në burgjet e kategorive të tjera.

Gratë dhe të miturit mund të vendosen në këto burgje dhe në seksione të burgut të sigurisë së lartë, për sjellje dhe vepra veçanërisht të rënda.

Vendosja e të dënuarit në burgun e sigurisë së lartë kur nuk është shprehur gjykata me vendim, bëhet me kërkesë të prokurorit tek ajo gjykatë. Kur i dënuari vuan dënimin dhe është vendi për transferimin e tij në një burg të sigurisë së lartë, sipas kriterëve të këtij ligji, kërkesa e prokurorit i paraqitet gjykatës së vendit ku ndodhet institucioni. Transferimi nga burgu i sigurisë së lartë në institucionet e tjera të vuajtjes së dënimit bëhet me kërkesë të vetë të dënuarit, pranë gjykatës ku ndodhet institucioni.

Në burgjet e sigurisë së lartë, vihen kufizime në të drejtat e të dënuarit, në rastet dhe sipas kriterëve të përcaktuara shprehimisht në këtë ligj.

Në burgjet e kategorive të tjera me urdhër të ministrit të Drejtësisë mund të krijohen seksione të burgut të sigurisë së lartë, në të cilat zbatohen rregullat e mësipërme.

Neni 14

Burgu i sigurisë së zakonshme

Burgjet e sigurisë së zakonshme janë institucionet ku vuhet dënimi nga gjithë të dënuarit, me përjashtim të atyre të sigurisë së lartë dhe të sëmurëve e të paaftëve fizikisht. Në burgjet e sigurisë së zakonshme format e trajtimit zbatohen pa kufizimin e burgjeve të sigurisë së lartë ose specifikat e institucioneve mjekësore.

Vendosja në burgjet e sigurisë së zakonshme bëhet nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve nëpërmjet organit kompetent që ekzekuton vendimin e gjykatës, sipas kriterëve që përcaktohen në këtë ligj dhe në rregulloren e burgjeve. Kalimi në një burg të sigurisë së ulët bëhet me urdhër të prokurorit.

Neni 15

Burgu i sigurisë së ulët

Burgjet e sigurisë së ulët janë institucionet ku vuhet dënimi për të dënuar për kundërvajtje penale ose vepra penale nga pakujdesia dhe që nuk janë përsëritës, si dhe të dënuarit e burgjeve të sigurisë së zakonshme, që u kanë mbetur më pak se 6 muaj burgim për të vuajtur, kur sjellja e tyre është e mirë.

Vendosja në burgjet e sigurisë së ulët bëhet fillimisht nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve sipas kritereve të këtij ligji dhe rregullores së burgjeve.

Transferimi në një burg të regjimit të zakonshëm bëhet me kërkesë të drejtorit të burgut dhe me miratim të prokurorit.

Në burgjet e sigurisë së ulët i jepet përparësi ekzekutimit të dënimit për gratë dhe të miturit.

Neni 16

Institutet për të sëmurët dhe të paaftët

Institucionet mjekësore të posaçme ose seksione të veçanta në burgje ose në spitale jashtë sistemit të burgjeve shërbejnë për mjekimin e të dënuarve të sëmurë ose me shqetësime mendore ose psikike.

Vendosja e personave në këto institucione dhe seksione mund të parashikohet që në fillim në vendimin e dënimit ose gjatë ekzekutimit të dënimit, me miratim të prokurorit dhe në raste që nuk presin, edhe nga drejtori i burgut, ku ndodhet i dënuari, duke vënë në dijeni menjëherë prokurorin.

Dalja nga këto institucione bëhet me propozim të drejtuesit të institucionit dhe me miratim të prokurorit.

Për vendosjen, refuzimin e vendosjes, daljen ose refuzimin e daljes, i dënuari, mbrojtësi ose kujdestari i tij kanë të drejtën e ankimit në gjykatë brenda 5 ditëve nga marrja dijeni.

Në institucionet dhe seksionet e mjekimit respektohen të gjitha të drejtat e të dënuarve sipas këtij ligji, për aq sa janë të zbatueshme në kushtet spitalore. Ministri i Drejtësisë dhe Ministri i Shëndetësisë me udhëzim të përbashkët përcaktojnë mënyrën e zbatimit të këtij ligji në to.

Me urdhër të prokurorit në këto institute mund të vendosen edhe të dënuar që kanë profesione që lidhen me mjekësinë ose fusha të tjera të nevojshme, kur për ta nuk ka pengesa sipas këtij ligji.

Vendosja e të dënuarve në këto institute bëhet nga gjykata në rastet e përcaktuara në Kodin e Procedurës Penale. Në këto institute, me rekomandim të shërbimit mjekësor të burgjeve ose të institucioneve të tjera mjekësore, të dënuarit me burgim transferohen me urdhër të prokurorit.

Dalja dhe vendosja e të dënuarve në burgje bëhet nga organi që ka vendosur ekzekutimin e vendimit në institut.

Neni 17

Vendet e dënimit për gratë dhe të miturit

Gratë dhe të miturit rregullisht e vuajnë dënimin në institucione të posaçme vetëm për to dhe në pamundësi, në seksione të veçanta të institucioneve të tjera sipas kritereve të këtij ligji.

Nënave u lejohet që të mbajnë me vete fëmijët deri në moshën 3 vjeç. Për kujdesin dhe asistencën ndaj këtyre fëmijëve funksionojnë çerdhe të posaçme.

Neni 18

Rregullorja e brendshme e institucioneve

Çdo institucion ka rregulloren e brendshme, të dalë mbi bazë të rregullores së burgjeve, që përcakton organizimin, disiplinën e brendshme dhe kërkesat e trajtimit në kushtet e institucionit.

Rregullorja e brendshme përgatitet nga një komision i caktuar dhe i kryesuar nga drejtori i institucionit dhe miratohet nga Ministri i Drejtësisë.

Neni 19

Organet drejtuese të burgjeve

Drejtorja e Përgjithshme e Burgjeve është organi qendror që organizon, drejton dhe kontrollon institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale dhe organizmat e veprimtarive ndihmëse.

Drejtorja e Përgjithshme realizon detyrën e saj në bazë të këtij ligji, rregullores së përgjithshme të burgjeve, urdhrave dhe udhëzimeve të ministrit të Drejtësisë, si dhe të gjitha akteve të tjera ligjore dhe nënligjore që përmbajnë rregulla për to.

Drejtori i institucionit organizon dhe kontrollon si më sipër veprimtarinë në institucionin përkatës dhe përgjigjet për ekzekutimin e vendimeve penale në të.

Neni 20

Drejtimi i strukturave

Drejtuesit e strukturave të institucioneve të përcaktuara në nenin 11 të këtij ligji, organizojnë dhe përgjigjen për veprimtarinë në zbatim të programit të trajtimit sipas fushës përkatëse.

Neni 21

Personeli zbatues

Personeli zbatues realizon dhe përgjigjet për zbatimin e programit të trajtimit sipas detyrës së caktuar.

Neni 22

Policia e burgjeve

Policia e burgjeve pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve është në varësi të ministrit të Drejtësisë, e cila realizon ruajtjen e institucioneve nga jashtë, mbështet dhe garanton realizimin e veprimtarisë së institucionit në zbatim të ligjit "Për Policinë e Burgjeve".

KREU III

KUSHTET E JETESËS NË INSTITUCION

Neni 23

Ndërtesat

Ndërtesat e burgjeve dhe instituteve të veçanta, të destinuara për t'u përdorur nga të dënuarit, duhet të jenë të ndërtuara dhe të strukturuara në mënyrë të tillë që të plotësojnë kërkesat për një jetë sa më normale dhe të sigurojnë realizimin e veprimtarive të programit të trajtimit.

Ndërtesat ekzistuese përshtaten gradualisht për t'u përdorur me ndarje të veçanta, nga grupe të dënuarish në numër sa më të kufizuar, ndërsa projektet e ndërtesave të reja miratohen për ndarje të përdorshme deri në 4 të dënuar, duke respektuar kubaturat e nevojshme.

Neni 24

Mjediset e qëndrimit dhe të fjetjes

Mjediset, në të cilat jetojnë të dënuarit, duhet të kenë hapësira të mjaftueshme, me ndriçim të nevojshëm natyror dhe artificial, për të bërë të mundur qëndrimin, punën dhe çlodhjen aktive, të ajrosura dhe të pajisura me shërbimet higjienike. Atje ku e kërkojnë kushtet klimaterike duhet të sigurohet edhe ngrohja e mjediseve.

Kur nuk është e mundur të sigurohet fjetja në dhoma individuale, caktimi i të dënuarve në të njëjtën dhomë duhet të bëhet në mënyrë të tillë, që të shmangen konfliktet dhe ndikimet negative të ndërsjella. Për këtë qëllim përdoren kriteret e grupmoshave, të llojit të veprave penale të kryera dhe të veçorive instelektuale e psikike të të dënuarve.

Për çdo të dënuar sigurohet shtrat i veçantë dhe një komplet i përshtatshëm fjetjeje.

Kuotat minimale për sipërfaqet, vëllimet, ndriçimin dhe ajrimin e mjediseve për të dënuarit, caktohen në rregulloren e burgjeve, sipas rekomandimeve të Ministrisë së Shëndetësisë.

Neni 25

Veshja dhe pajisjet

Çdo të dënuari i sigurohet veshmbathje dhe pajisje të tjera individuale në sasi të mjaftueshme, në gjendje të mirë dhe të pastra, të tilla që të sigurojnë plotësimin e kërkesave normale të jetesës.

Të dënuarit mund të mbajnë me leje të administratës, veshmbathje dhe sende të përdorimit vetjak, të cilat duhet të jenë të pastra dhe të përshtatshme, si dhe të objekteve që kanë një vlerë të veçantë morale ose personale.

Neni 26

Higjiena vetjake dhe e mjedisit

Të dënuarit i sigurohen mjediset, pajisjet dhe mjetet e nevojshme për pastërtinë vetjake, në përpjesëtim me numrin e përdoruesve, që të garantojë në mënyrë sa më optimale higjienën vetjake.

Çdo institucion siguron shërbime periodike të pastrimit të mjediseve, veshmbathjes dhe pajisjeve vetjake, si dhe të qethjes dhe të rruajtjes.

Higjiena vetjake, qethja dhe rruajtja mund të bëhen me detyrim vetëm për arsye të veçanta higjieno-sanitare, sipas kërkesës së shërbimit mjekësor dhe me urdhër të drejtorit të institucionit.

Neni 27

Ushqimi

Të dënuarve u sigurohet ushqim i shëndetshëm dhe i mjaftueshëm, i përshtatshëm për moshën, gjendjen shëndetësore, punën, klimën dhe stinën.

Ushqimi përgatitet dhe jepet si rregull në mjedise të caktuara për këtë qëllim. Me leje të drejtorit të institucionit, në raste të veçanta, të dënuarit mund të përgatisin dhe të konsumojnë ushqimin individualisht.

Norma e ushqimit ditor përcaktohet nga tabelat përkatëse të miratuara nga Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Shëndetësisë.

Administrata e institucionit pranon ushqime tërësisht ose pjesërisht për të dënuarit ose i siguron ato me shpenzimet e tij duke respektuar kufijtë e rregullores së brendshme.

Të dënuarve duhet t'u sigurohet në vazhdimësi ujë i pijshëm.

Neni 28

Koha e ajrimit

Të dënuarit që nuk punojnë jashtë dhe të gjithë të dënuarit e tjerë, në ditët që nuk punohet, kanë të drejtë të qëndrojnë në ajrim në mjedise të hapura jo më pak se 2 orë në ditë.

Kjo periudhë kohe mund të reduktohet, por jo më pak se 1 orë në ditë për shkaqe të jashtëzakonshme dhe vetëm me urdhër të drejtorit të institucionit.

Ajrimi në mjedise të hapura bëhet në grupe, përveç të dënuarve që janë me masa izolimi.

Neni 29

Shërbimi shëndetësor

Administrata e institucionit siguron kushtet, mjetet dhe personelin për mbrojtjen e shëndetit të të dënuarve.

Organizimi dhe realizimi i shërbimit shëndetësor bëhet nga administrata e institucionit në bashkëpunim me spitalin e burgjeve, dhe me organet shtetërore kompetente të shëndetësisë.

Shërbimi shëndetësor duhet të sigurojë:

1. Diagnostikimin dhe mjekimin e sëmundjeve.
2. Furnizimin me ilaçe dhe pajisje mjekësore.

3. Profilaksinë për sëmundjet, duke bërë kujdes të veçantë për sëmundjet infektive dhe atyre ngjitëse.

4. Sigurimin e higjienës së mjedisit dhe edukimin sanitar të të dënuarve.

5. Masat siguruese për proceset e veçanta të trajtimit dhe të punës.

Çdo institucion ka shërbim shëndetësor e farmaceutik që i përgjigjet nevojave për parandalimin dhe ruajtjen e shëndetit të të dënuarve.

Të dënuarit, që dyshohen ose kanë sëmundje ngjitëse, izoloohen menjëherë në ndarje të posaçme. Në rastet kur dyshohet për sëmundje psikike, zbatohen pa vonesë masat e duhura, duke respektuar rregullat që lidhen me asistencën psikiatrike dhe shëndetin mendor.

Në instituconet ku vuajnë dënimin gratë, funksionojnë shërbimet speciale në ndihmë të grave shtatzana dhe të atyre me fëmijë në gji.

Për rastet e sëmundjeve ngjitëse ose të sëmundjeve, diagnostikimi dhe mjekimi i të cilave nuk mund të garantohet në kushtet e institucionit, të dënuarit transferohen në spitalin e burgjeve dhe, kur është e nevojshme, edhe në institucione shëndetësore jashtë sistemit të burgjeve, sipas rregullave të parashikuara në nenin 15 të këtij ligji.

PJESA E TRETË PRANIMI DHE TRAJTIMI I TË DËNUARVE NË INSTITUCION

KREU I PRANIMI

Neni 30

Pranimi i të dënuarve

Në çdo institucon krijohet një shërbim për të pranuar të sapoardhurit, për t'u dhënë informacion fillesatar mbi rregullat e burgut dhe për të parandaluar ndikimet negative nga ndryshimi i mjedisit ose rreziqet e mundshme për të dënuarit e tjerë.

Me pranimin në institucion, i dënuari i nënshtrohet menjëherë një vizitë mjekësore të përgjithshme dhe analizave përkatëse për përcaktimin e gjendjes shëndetësore, veçorive fizike dhe psikike, si dhe të aftësisë për punë.

Mbi bazën e dokumentacionit shoqërues dhe shpjegimeve gojore, formulohen të dhënat individuale të të dënuarit lidhur me personalitetin e tij.

Mbi bazën e këtyre të dhënave përpilohet kartela e vëzhgimit paraprak të të dënuarit dhe programohet trajtimi individual i tij.

Neni 31

Diferencimi i institucioneve për qëllime trajtimi caktimi dhe grupimi i të dënuarve

Institucionet dhe seksionet e veçanta janë të organizuara sipas nevojave të trajtimit individual ose në grup të të dënuarve.

Numri i të dënuarve në institucione dhe në seksione përgjithësisht, sistemimi dhe aktivizimi i tyre posaçërisht janë të kufizuara në atë masë që të favorizojnë trajtimin e individualizuar.

Lejohet pranimi i të dënuarve në veprimtari të veçanta, të organizuara në institucione ose seksione të një kategorie të ndryshme nga ato ku janë caktuar, me përjashtim të atyre të sigurisë së lartë.

Grupimi i të dënuarve brenda institucioneve të veçanta bëhet duke pasur parasysh mundësinë që ata të përfitojnë nga një trajtim i diferencuar në grup, në përputhje me kërkesat dhe angazhimin e tyre.

Duhet të favorizohet kriteri i caktimit të të dënuarve në institucione pranë vendbanimit të familjeve të tyre.

KREU II DREJTIMET DHE FORMAT E TRAJTIMIT

Neni 32 **Trajtimi**

Trajtimi i të dënuarve bëhet duke siguruar mjediset e përshtatshme dhe në përputhje me të dhënat e personalitetit të tyre.

Objektivat e trajtimit përfshijnë arsimimin, formimin profesional, zhvillimin e aftësive të tjera individuale, veprimtaritë kulturore, çlodhëse e sportive, punën, asistencën shpirtërore dhe veprimtari të tjera në grup që kanë si qëllim rikrijimin e aftësisë për t'i integruar në shoqëri.

Trajtimi social-edukativ i të dënuarve zhvillohet me anë të veprimeve individuale dhe të veprimtarive formuese, që realizohen nga ana e personelit të burgjeve të aftësuar posaçërisht në fushën pedagogjike, në bashkëpunim me punonjësit e tjerë të institucionit.

Kontaktet me botën e jashtme dhe familjen inkurajohen dhe sigurohen sipas programeve individuale dhe grupore.

Neni 33 **Shërbimi mjekësor**

Shërbimi mjekësor sigurohet gjatë gjithë kohës së qëndrimit në institucion, pavarësisht nga kërkesat e të dënuarve.

Personeli mjekësor duhet të evidentojë dhe të njoftojë menjëherë për sëmundjet që kërkojnë trajtim të specializuar.

Të dënuarit mund të kërkojnë që të vizatohen, me shpenzimet e tyre, nga një mjek që duan ata.

Kur mjekimi i të dënuarit nuk mund të bëhet nga shërbimi shëndetësor i institucionit, me urdhër të prokurorit transferohet në spitalet e burgut dhe, kur është e nevojshme, edhe në institucionet e tjera mjekësore.

Në raste që nuk presin drejtoria e institucionit është kompetente të veprojë si më sipër me iniciativë, duke vënë në dijeni menjëherë prokurorin.

I dënuari, mbrojtësit dhe kujdestari ligjor i të miturit kanë të drejtë të ankohen në gjykatë brenda 5 ditëve nga refuzimi i kërkesës për dërgimin në mjekim sipas këtij neni.

Neni 34 **Puna**

Puna organizohet nga drejtoria brenda dhe jashtë institucionit duke shfrytëzuar edhe ndihmën e subjekteve të tjera.

Gjatë vuajtjes së dënimit me burgim nuk mund të detyrohen të punojnë të dënuarit që kanë plotësuar kushtet për pension pleqërie, që janë invalidë të grupit të parë dhe të dytë, gratë shtatëzana, për aq kohë sa parashikon ligji në fuqi, si dhe personat që nuk janë në gjendje fizike dhe shëndetësore të kryejnë punën që u ofrohet. Të dënuarit që kanë probleme psikike mund të vihen në punë kur kjo i shërben qëllimeve terapeutike.

Puna nuk ka karakter dënimi dhe shpërblehet sipas kriterëve të përcaktuara me vendim të veçantë të Këshillit të Ministrave.

Neni 35 **Kushtet e punës**

Kushtet e punës duhet të jenë si në shoqërinë e lirë, me qëllim që të dënuarit të përfitojnë aftësi profesionale për të lehtësuar riintegrimin e tyre në shoqëri.

Të dënuarit që tregojnë aftësi për veprimtari shkencore, kulturore, artistike ose të artizanatit, mund të lejohen që të ushtrojnë me shpenzimet dhe për llogari të tyre këto veprimtari.

Kohëzgjatja e punës nuk mund të kalojë kufijtë e përcaktuar nga Kodi i Punës.

Puna është me shpërblim dhe përfshihet në vjetërsinë në punë për efekt pensioni.

Neni 36

Caktimi i punës

Objekti i punës duhet t'u përshtatet kërkesave të veçanta të personalitetit të secilit nga të dënuarit në perspektivën e riintegritit në shoqëri.

Kur në institucion nuk është e mundur të sigurohet puna për të dënuarit, tërësisht ose pjesërisht, mund të sigurohen fronte pune jashtë institucionit, duke aktivizuar të dënuarit me kriterin e aftësisë për punë, formimin profesional dhe duke preferuar të dënuarit që kanë pasur më pak aktivizim pune.

Në çdo rast, dalja jashtë institucionit dhe kryerja e punës bëhen gjithmonë të shoqëruar nga personeli i institucionit dhe të ruajtur nga policia e burgjeve.

Neni 37

Arsimimi

Arsimimi dhe formimi kulturor e profesional bëhet me anë të organizimit të shkollës, e detyrueshme për të miturit, si dhe të kurseve profesionale, sipas simeve në fuqi.

Nxitet kryerja dhe favorizohet ndjekja e studimeve profesionale, duke përdorur kurset me korrespondencë.

Favorizohet leximi pa kufizim i publikimeve dhe përdorimi i sistemeve të tjera informative të bibliotekës së institucionit.

Kujdes i veçantë i kushtohet formimit kulturor e profesional të të dënuarve me moshë nën 25 vjeç.

Neni 38

Veprimtaritë kulturore, çlodhëse e sportive

Organizimi i veprimtarive kulturore, çlodhëse e sportive duhet të synojë ruajtjen dhe zhvillimin e aftësive fizike, shpirtërore dhe psikike të të dënuarve.

Neni 39

Mjediset dhe kushtet materiale të trajtimit

Në institucionet e vuajtjes së dënimit dhe riedukimit, sipas kërkesave të trajtimit, duhet të sigurohen mjediset dhe mjetet e përshtatshme dhe të nevojshme për zhvillimin e punës, arsimimin shkollor dhe profesional, veprimtaritë çlodhëse, kulturore dhe çdo veprimtari tjetër të përbashkët ose individuale.

Institucionet duhet të jenë të pajisura me një bibliotekë librash dhe botime periodike.

Neni 40

Lidhjet me familjen

Kujdes i veçantë i kushtohet ruajtjes, përmirësimit ose rivendosjes së lidhjeve të të dënuarve me familjen.

I dënuari mund të informojë menjëherë familjarët për futjen e tyre në një institucion ose kur transferohet prej tij.

Në rast vdekjeje ose sëmundjeje të rëndë fizike ose psikike të një të dënuari, duhet të njoftohen menjëherë familjarët.

Institucioni njofton menjëherë të dënuarin kur vihet në dijeni për vdekjen e të afërmeve të tij. Për të dënuarit e sëmurë rëndë ose me shqetësime psikike, njoftimi bëhet vetëm me pëlqimin e mjekut.

Për të dënuarit e mitur dhe për gratë që kanë fëmijë të mitur, bëhet një program i posaçëm dhe favorizues për lidhjet me familjen.

Neni 41

Takimet, vizitat, korrespondencat dhe informacioni

Të dënuarit lejohen që të kenë takime dhe korrespondenca me familjarët dhe persona të tjerë.

Takimet zhvillohen në vende të veçanta nën kontroll shikimi dhe jo dëgjimi nga personeli mbikëqyrës.

Favorizohen veçanërisht takimet me familjarët.

Kur organizimi i institucionit e lejon, të dënuarit mund të autorizohen të rrinë me familjarët përtej kufirit kohor të parashikuar. Sipas kriterëve të rregullores së burgjeve vizitat mund të bëhen në vende të rezervuara.

Administrata e institucionit vë në dispozicion të të dënuarve, që nuk i kanë mundësitë, mjetet e nevojshme për korrespondencën.

Korrespondenca telefonike mund të autorizohet në marrëdhëniet me familjarët, në raste të veçanta me të tretët.

Të dënuarit lejohen të mbajnë gazeta, revista e libra që janë në shitje të lirë jashtë dhe të shfrytëzojnë mjete të tjera informacioni të lejuara.

Me kërkesë të prokurorit në rastet e parashikuara në ligj, gjykata lejon kontrollin e korrespondencës së të dënuarit. Kontrolli mund të bëhet nga drejtori i institucionit ose nga persona të autorizuar prej tij në prani të prokurorit. Kërkesa e prokurorit pezullon dorëzimin e korrespondencës.

Neni 42

E drejta e besimit dhe ushtrimi i riteve fetare

Të dënuarit kanë të drejtën e besimit dhe të ushtrimit të riteve. Për ushtrimin e riteve, institucioni siguron mjedise të veçanta.

Të dënuarit kanë të drejtë të marrin kontakt me përfaqësues të komuniteteve fetare, të caktuar në marrëveshje mes Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe komuniteteve fetare të njohura ligjërisht.

Neni 43

Vizitat në institucion

vendimeve me burgim, personat e jashtëm mund të futen vetëm me autorizim të ministrit të Drejtësisë për burgjet e sigurisë së lartë dhe në institucionet e tjera, sipas rregullores së burgjeve.

Prokurori mund të autorizojë drejtpërdrejt përfaqësues të organizatave joqeveritare të vizitojnë institucionet ku ndodhen të dënuar apo të paraburgosur, për verifikimin e pretendimeve që lidhen me garantimin dhe respektimin e të drejtave të tyre.

2. Institucionet mund të vizitohen pa autorizim nga:

Presidenti i Republikës, Kryetari i Kuvendit Popullor, Kryeministri dhe stafi i tyre shoqërues; kryetari i Gjykatës Kushtetuese, kryetari i Gjykatës së Kasacionit, Prokurori i Përgjithshëm dhe zëvendësat e tij, deputetët e zonës elektorale ku ndodhet institucioni, ministri i Drejtësisë, drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve, zëvendësat e tij, si dhe drejtori i Policisë së Burgjeve.

3. Me përjashtim të burgjeve të sigurisë së lartë, në institucionet e tjera të vuajtjes së dënimit mund të hyjnë pa autorizim: ministrat, gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, zëvendësministrat, sekretarët e shtetit, deputetët e Kuvendit Popullor dhe anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe prefekti;

kryetarët dhe prokurorët e Gjykatës së Apelit, kryetarët e gjykatave dhe prokurorët e rretheve, gjyqtarët gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre, si dhe avokatët e kërkuar nga të dënuarit ose të caktuar kryesisht.

4. Nuk është i nevojshëm autorizimi për ata që shoqërojnë personat e përmendur në pikën 3 të këtij neni, me përjashtim të burgjeve të sigurisë së lartë, por kurdoherë jo më shumë se dy.

5. Oficerët e policisë gjyqësore mund të hyjnë në institucione për shkaqe pune, me anë të një autorizimi të dhënë nga prokurori.

Në rastet e ngutshme autorizimi jepet nga drejtuesi i institucionit.

6. Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve përcakton punonjësit që kanë të drejtë të hyjnë në

institucione.

7. Për përfaqësuesit e komuniteteve fetare zbatohen rregullat e parashikuara në nenin 42 të këtij ligji.

Vizitorët, kur konstatojnë ose marrin ankesa dhe kërkesa nga të dënuarit lidhur me zbatimin e ligjit dhe të rregullores së burgjeve, bëjnë rekomandime të drejtpërdrejta te drejtori i institucionit ose tek eprorë të tij dhe, kur e shohin me vend, i paraqesin kërkesë prokurorit.

PJESA E KATËRT REGJIMI NË INSTITUCION

KREU I NORMAT E SJELLJES, ZHDËMTIMI DHE PËRGJEGJËSIA DISIPLINORE

Neni 44

Normat e sjelljes së të dënuarve

Rregullorja e burgjeve dhe ajo e brendshme e institucionit përcaktojnë rregulla lidhur me trajtimin, regjimin dhe sjelljen e të dënuarve, duke vendosur kufizime të nevojshme për atë që nuk cenohen kërkesat e këtij ligji dhe synimi për riedukimin e tyre.

Me rastin e pranimit në institucion dhe gjatë vuajtjes së dënimit, të dënuarit janë të detyruar të njohin dhe respektojnë rregullat e brendshme, dispozitat që lidhen me të drejtat dhe detyrat e tyre, të trajtimit dhe të disiplinës.

Asnjë të dënuari nuk mund t'i caktohen detyra në shërbimet në institucion, që i japin atij një pozicion sundues ose favorizues ndaj të dënuarve të tjerë.

Neni 45

Përgjegjësia për dëmet

Të dënuarit detyrohen të kujdesen për sendet e vëna në dispozicion të tyre, si dhe të shmangin çdo lloj dëmtimi të sendeve të të tjerëve.

Të dënuarit që shkaktojnë dëm material ndaj administratës së institucionit ose personave të tjerë, duhet ta dëmshpërblejnë atë.

Neni 46

Izolimi

Në institucionet, izolimi vendoset:

- kur parashikohet për arsye shëndetësore;
- në ekzekutim të masës së vendosjes në regjim të mbikëqyrjes së veçantë;
- në rastet e parashikura në nenin 13 të këtij ligji;
- në të gjitha rastet e personave të arrestuar dhe të ndaluar.

Neni 47

Kontroll vetjak

I dënuari i nënshtrohet kontrollit vetjak në çdo rast të hyrjes apo daljes nga institucioni dhe, në raste të tjera, kur ka shkaqe të arsyeshme.

Kontrolli vetjak duhet të bëhet, duke respektuar dinjitetin e të dënuarit.

Kontrolli mund të bëhet vetëm nga persona me të njëjtin seks me të dënuarin.

Me autorizim të drejtorit të institucionit, në rastet dhe mënyrën që parashikohet në rregulloren e burgjeve, mund të bëhen edhe kontrole të anësive.

Neni 48

Disiplinimi i lëvizjeve

Lëvizjet e të dënuarve jashtë institucionit bëhen në një kohë mundësisht sa më të shkurtër me shoqërim nga Policia e Burgjeve sipas rregullave të caktuara. Lëvizja e grave bëhet me asistencë të personelit të të njëjtit seks, ndërsa i të sëmureve, të shoqëruar nga personeli mjekësor.

Gjatë lëvizjes tregohet kujdesi i duhur, për të mbrojtur të dënuarit që transferohen, nga kureshtja i njerëzve dhe çdo lloj publiciteti tjetër, si dhe për të mos u krijuar shqetësime atyre.

Në lëvizjet individuale përdorimi i prangave është i detyrueshëm, kur e kërkon rrezikshmëria e lartë e të dënuarit ose rrethanat e mjedisit, që e bëjnë të vështirë transferimin.

Në lëvizjet kolektive është gjithmonë i detyrueshëm përdorimi i prangave ose i mjeteve të tjera shtrënguese.

Neni 49

Ankesat

Të dënuarit mund t'ua paraqesin ankesat me gojë ose me shkrim edhe në zarf të mbyllur: drejtorit të institutit, inspektorëve, Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve dhe Ministrit të Drejtësisë;

gjykatës së vendit të ekzekutimit të vendimit dhe prokurorit të rrethit;

personave që vizitojnë institucionin sipas nenit 43 të këtij ligji.

Institucioni është i detyruar të evidentojë ankesat dhe mënyrën e zgjidhjes së tyre.

Për ankesat me shkrim dokumentohet marrja dhe dërgimi në destinacion.

Neni 50

Afatet e shqyrtimit të ankesave dhe të kërkesave

Organet kompetente sipas këtij ligji shqyrtojnë ankesat dhe kërkesat sa më parë, por jo më vonë se 1 muaj nga paraqitja e tyre, përveç kur ka afate të posaçme me dispozita të veçanta.

I dënuari ka të drejtë të paraqesë para prokurorit ose në gjykatën e vendit ku vuan dënimin ankesë të veçantë për zvarritjen e shqyrtimit të ankesave dhe kërkesave.

Kur zgjidhja e ankesës ose kërkesës është në kompetencë të organeve të sistemit të burgjeve, prokurori urdhëron përfundimin e shqyrtimit brenda një afati të caktuar.

Në të gjitha rastet e tjera një urdhërim të tillë e bën gjykata.

Neni 51

Regjimi disiplinor

Regjimi disiplinor realizohet në mënyrë që të stimulojë sensin e përgjegjësisë dhe aftësinë e vetëkontrollit. Ai i përshtatet seksit, moshës, të dhënave fizike dhe psikike të të dënuarve.

Neni 52

Shkeljet disiplinore

Të dënuarit nuk mund të ndëshkohen për një fakt që nuk është parashikuar shprehimisht si shkelje në këtë ligj, në rregulloren e burgjeve dhe rregulloren e institucionit.

Ndëshkimi mund të jepet vetëm pas dëgjimit dhe verifikimit të pretendimit të të dënuarit.

Ndëshkimet caktohen në përputhje me llojin dhe rëndësinë e shkeljes, qëndrimin e të dënuarit ndaj saj, si dhe të dhënat individuale të tij.

Ndëshkimet zbatohen duke respektuar personalitetin e të dënuarit.

Neni 53

Masat disiplinore

1. Për shkeljet disiplinore zbatohen këto masa:

a) Qortim individual;

b) Vërejtje në prani të të dënuarve;

c) Përrjashtim nga veprimtari të veçanta, të përbashkëta deri në 10 ditë;

- ç) Përrjashtim nga ajrosja në grup për jo më shumë se 20 ditë;
- d) Përrjashtimi nga të gjitha veprimtaritë e përbashkëta deri në 20 ditë;
- dh) Ndërprerja e lejeve.

Ndaj të miturve dhe grave masat e parashikuara në shkronjat “c”, “ç” dhe “d” mund të jepen deri në gjysmën e kohës së parashikuar. Për gratë shtatzëna ose që u është lënë fëmija, mund të zbatohen vetëm masat disiplinore të parashikuara në shkronjat “a” dhe “b” të këtij neni.

Në rregulloren e burgjeve masat e mësipërme mund të diferencohen në varësi të llojit të institucionit, pa kaluar kufijtë maksimalë.

2. Masa disiplinore e përrjashtimit nga veprimtaritë e përbashkëta dhe ajrosja në grup nuk mund të bëhet pa një dokument me shkrim, të lëshuar nga mjeku, që dëshmon se i dënuari mund ta përballojë atë. I dënuari, ndaj të cilit merret kjo masë, i nënshtrohet kontrollit të vazhdueshëm mjekësor.

Neni 54

Organi kompetent për dhënien e masave disiplinore

Masat disiplinore të vërejtjes dhe të qortimit vendosen nga drejtori i institucionit.

Masat e tjera vendosen nga këshilli disiplinor i përbërë nga drejtori ose zëvendësi i tij, me funksionin e kryetarit, nga sanitari, edukatori dhe komandanti i policisë.

Masat disiplinore evidentohen në kartelën e të dënuarit dhe konsiderohen të padhëna në rast mospërsëritjeje për një periudhë 6-mujore.

Neni 55

Regjimi i mbikëqyrjes së veçantë

I dënuari mund të vendoset nën regjimin e mbikëqyrjes së veçantë, në burgjet ose seksionet e sigurisë së lartë, për një periudhë jo më të gjatë se 3 muaj, kur:

- a. rrezikojnë sigurinë ose prishin rregullin në institucion;
- b. pengojnë veprimtaritë e të dënuarve të tjerë nëpërmjet dhunës dhe kërcënimeve;
- c. përpiqen të detyrojnë të dënuarit e tjerë që t’ju nënshtrohen ose të përfitojnë prej tyre;
- ç. nxisin të tjerët të mos zbatojnë ose të shkelin rregullat individualisht ose në grup.

Për vendosjen e të dënuarve në regjimin e mësipërm zbatohen kriteret dhe rregullat e parashikuara në nenin 12 të këtij ligji.

Në rast nevojë urgjente, drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve urdhëron drejtpërdrejt për kalimin e përkohshëm të të dënuarit në regjimin e mbikëqyrjes së veçantë, duke vënë menjëherë në dijeni për këtë prokurorin, i cili brenda 24 orëve, i paraqet kërkesën gjykatës, e cila me vendim konfirmon ose anulon masën e përkohshme.

Ndaj të dënuarit, i cili gjatë regjimit të mbikëqyrjes së veçantë kryen shkelje të parashikuara në këtë nen, mund të shtyhet koha e regjimit deri në 3 muaj për çdo rast, duke u respektuar rregullat e marrjes së kësaj mase.

Neni 56

Përmbytja e regjimit të mbikëqyrjes së veçantë

Regjimi i mbikëqyrjes së veçantë përmban kufizimet më të nevojshme për mbajtjen e rregullit dhe të sigurisë, për ushtrimin e të drejtave të të dënuarve dhe për rregullat e trajtimit të parashikuara në rregulloren e burgjeve.

Për çdo rast, shtrëngesat nuk kanë të bëjnë me kërkesat e higjienës, të shëndetit, të veshjes, të ushqimit, të pajisjeve, me mbajtjen, blerjen dhe marrjen e ushqimeve ose objekteve të tjera të parashikuara nga rregullorja e institucionit, me leximin e librave, me praktikën fetare, me përdorimin e aparateve radio të tipit të lejuar, me ajrosjen, me bisedimet me avokatin mbrojtës, si dhe me bashkëshortët, fëmijët dhe për të miturit me prindërit.

Neni 57

Përdorimi i forcës fizike dhe i mjeteve shtrënguese

Nuk lejohet përdorimi i forcës fizike ndaj të dënuarve, nëse nuk është e domosdoshme për të ndaluar aktet e dhunshme, tentativat e largimit nga institucioni, si dhe për mposhtjen e kundërshtimit edhe kur ai është pasiv, në zbatimin e urdhrave të dhëna.

Personeli, i cili për çdo lloj arsye ka përdorur forcën fizike ndaj të dënuarve, duhet menjëherë të verë në dijeni me shkrim drejtorin e institucionit, i cili nga ana e tij bën kontrollin dhe siguron ndihmën shëndetësore të të dënuarve dhe vetëm pas kësaj verifikon çështjen.

Mjetet e shtrëngimit fizik nuk mund të përdoren si ndëshkim, por vetëm në rastet që parashikohen shprehimisht në rregullore dhe për të shmangur përpjekjet për largimin nga institucioni, dhunën ndaj personave, dëmtimin e sendeve, si dhe për të garantuar shëndetin e vetë të dënuarit.

Përdorimi i mjeteve të shtrëngimit fizik duhet të jetë i kufizuar në kohë dhe për kalimin për një periudhë mbi 72 orë duhet të merret miratimi i prokurorit.

Gjatë shtrëngimit fizik, i dënuari duhet të jetë nën kontrollin e vazhdueshëm të shërbimit shëndetësor.

Neni 58

Llojet dhe natyra e forcës dhe mjeteve të shtrëngimit

Në rregulloren e burgjeve përcaktohen llojet, natyra e forcës dhe e mjeteve të shtrëngimit dhe rregullat e përdorimit të tyre me funksion parandalues dhe në përputhje me individualitetin e të dënuarit. Ndalohet përdorimi i mjeteve të forcës dhe atyre shtrënguese, që formojnë armë ose i lëndëve narkotike në kuptim të Kodit Penal, si dhe ato që kanë natyrë torturuese dhe hipnoze.

Policët e shërbimit brenda institutit nuk duhet të mbajnë armë, me përjashtim të rasteve të parashikuara në ligjin “Për Policinë e Burgjeve”.

KREU II

LEJET, SHPËRBLIMET DHE NDRYSHIMI I GJENDJES CIVILE

Neni 59

Lejet shpërblyese

Për respektimin e rregullores së burgjeve, për pjesëmarrje aktive në programet e trajtimit ose për veprime e sjellje të veçanta qytetarie, të dënuarit mund t’i jepet leje shpërblyese në një ose disa raste, por jo më shumë se 20 ditë në vit.

Lejet jepen për t’i krijuar të dënuarit mundësi afektive, kulturore dhe pune, kur gjatë qëndrimit në burg ka manifestuar një sens përgjegjësie dhe korrektese dhe krijon besimin e një qëndrimi të mirë jashtë institucionit. Mosdhënia e lejes së zakonshme motivohet vetëm si masë disiplinore në përputhje me nenin 51 gërma “dh” e këtij ligji, si dhe në rastet e një situate të jashtëzakonshme.

Leja e zakonshme në burgjet dhe seksionet e sigurisë së lartë jepet vetëm me urdhër të ministrit të Drejtësisë kur çmohet prej tij.

Për çdo leje të dhënë të dënuarve, drejtori i institutit vë menjëherë në dijeni Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve.

Neni 60

Leje të veçanta

Në raste vdekjeje ose për ngjarje të rëndësishme familjare, drejtori i institucionit mund t’i japë të dënuarit leje të veçantë, për të qenë i pranishëm. Kjo periudhë përfshihet në kohën e vuajtjes së dënimit.

Leja e veçantë mund të jepet deri 7 ditë dhe me kërkesë të të dënuarit mund të zgjatet për aq sa e imponojnë rrethanat.

Në rast refuzimi, prokurori mund të urdhërojë dhënien ose zgjatjen e lejes.
Në burgjet e sigurisë së lartë leja e veçantë jepet nga drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve.

Neni 61

Detyrimet gjatë lejes dhe përgjegjësia për shkeljet

I dënuari është i detyruar të respektojë kohën e lejes, ta kryejë atë në vendin për të cilën i është dhënë, të respektojë të gjitha detyrat dhe kushtëzimet që i janë dhënë dhe të njoftojë institucionin për çdo shmangie të imponuar.

Për mos respektimin e rregullave të mësipërme drejtori i institucionit ndërpret lejen, ndërsa për rastet e tejkalimeve në kundërshtim me kriteret e neveve 59 dhe 60 të këtij ligji, kërkohet nisja e procedimit penal sipas nenit 323 të Kodit Penal.

Neni 62

Shpërblimet

Të dënuarit mund t'i jepet shpërblim për zbatimin shembullor të rregullave, për gjeste të veçanta me karakter human, për aktivizimin e mirë në punë dhe në veprimtaritë e tjera në grup.

Shpërblimet dhe organet kompetente që i japin ato, parashikohen në këtë ligj dhe në rregulloren e brendshme.

Neni 63

Ulja e dënimit

Të dënuarit që zbatojnë rregullat dhe kanë një pjesëmarrje shembullore në veprimtaritë trajtuese, duke dhënë prova për riintegrim në shoqëri, mund të përfitojnë një ose disa ulje, deri 90 ditë në çdo vit të vuajtjes së dënimit. Në burgjet e sigurisë së lartë ulja e dënimit bëhet deri 45 ditë në vit.

Për dhënien e këtij shpërblimi të veçantë, vlerësohet qëndrimi i të dënuarit nga ulja e mëparshme ose gjatë 12 muajve të fundit.

Ulja e dënimit bëhet me vendim të gjykatës mbi kërkesën e të dënuarit të prokurorit ose të drejtorit të institucionit.

Neni 64

Ndryshimet në gjendjen civile

Faktet e martesave, të lindjeve, vdekjeve dhe fakte të tjera të kësaj natyre të ndodhura gjatë qëndrimit në institucion të të dënuarit, evidentohen në regjistër të veçantë, por në regjistrat e gjendjes civile nuk pasqyrohet statusi i subjektit.

Drejtorja e institutit duhet t'u japë menjëherë lajmin e vdekjes të të dënuarit autoriteteve gjyqësore vendore, Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe familjarëve.

Kufoma vihet në dispozicion të të afërmeve pas dhënies së lejes nga prokurori. Kur nuk ka të tillë ose kur refuzohet marrja, vendoset në varrezat publike. Për shtetasit e huaj vendosja në varrezat publike mund të bëhet vetëm pas njoftimit nga Ministria e Jashtme.

Neni 65

Depozitat

Shumat në para të të dënuarve depozitohen pranë zyrës së llogarisë në institucion dhe, kur janë mbi limitet e parashikuara në ligj, jashtë tij, duke i dhënë dokumentin përkatës sipas ligjit.

I dënuari mund të disponojë depozitën sipas ligjit dhe kriterëve të parashikura në rregulloren e burgut.

KREU III

TRANSFERIMET DHE LIRIMI

Neni 66

Rregullat e transferimit

Transferimet bëhen për arsye të rënda sigurie, kur rrezikohet jeta ose shëndeti i të dënuarit nga të tjerët, kur ka mbipopullim në institucion, për nevoja të hetimit dhe gjykimit, për shkaqe shëndetësore dhe familjare, si dhe kur për shkak të formimit profesional është i nevojshëm në një institucion tjetër.

Transferimet duhet të favorizojnë mundësi që të dënuarit ta kryejnë dënimin pranë vendbanimeve të familjeve të tyre.

Të dënuarit duhet të transferohen së bashku me sendet vetjake.

Neni 67

Lirimi

Lirimi i të dënuarve bëhet kur përfundon ekzekutimi i vendimit të dënimit ose në bazë të ligjit, me vendim të organit kompetent. Administrata kryen veprimet me urdhër me shkrim të drejtorit të institucionit. Në burgjet e sigurisë së lartë urdhri i lirimit jepet nga drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve.

Për të dënuar që nuk kanë mjete financiare dhe veshmbathje, me urdhër të drejtorit të institucionit i jepet një ndihmë në sasinë dhe sipas kriterëve të rregullores së burgjeve.

Në të gjitha rastet kur rezulton që i liruari do të hasë në vështirësi për kthimin në jetën e lirë, drejtori i institucionit njofton për këtë organet e pushtetit lokal, ku banon i dënuari për asistencë të mëtejshme.

Për të dënuarit e mitur është i detyrueshëm njoftimi paraprak i prindërve ose kujdestarit të tij.

Gjykata që ka dhënë vendimin, organet e policisë lokale dhe Ministria e Brendshme njoftohen menjëherë për lirimin e të dënuarit dhe në raste të veçanta edhe paraprakisht. Për shtetasit e huaj njoftohet Ministria e Punëve të Jashtme nëpërmjet Ministrisë së Drejtësisë.

Të liruarit i jepet një vërtetim lirimi në të cilin saktësohet kohëzgjatja e vuajtjes së dënimit, uljet dhe përfitimet që ka pasur për shkak të ligjit, si dhe kohëzgjatja e lloji i punës së kryer në institucion.

Me kërkesën e tij mund të jepet edhe vërtetim me të dhëna për aftësimin profesional të fituar, si dhe njoftime për sjelljen në burg.

PJESA E PESTË

MBIKËQYRJA NË EKZEKUTIM

Neni 68

Ushtrimi i mbikëqyrjes

Zbatimi i ligjit dhe rregullave në institucionet e vuajtjes së dënimit, realizimi dhe mbrojtja e të drejtave të të dënuarve mbikëqyret nga prokurori i caktuar posaçërisht në prokurorinë e territorit në të cilin ndodhet institucioni.

Në burgjet e sigurisë së lartë mbikëqyrja bëhet nga prokurorë të autorizuar nga Prokurori i Përgjithshëm.

Në të gjitha kategoritë e institucioneve për zbatimin e ligjit dhe rregullave përkatëse, të drejtën e kontrollit e ka edhe Këshilli i Mbikëqyrjes, krijuar në bazë të ligjit “Për vënien në ekzekutim të vendimeve penale”. Mbi bazë kërkesë, ankese ose kryesisht, ai ka të drejtë të bëjë të gjitha verifikimet e nevojshme dhe, mbi bazën e tyre, të kërkojë marrjen e masave nga drejtoria e institucionit, t’i rekomandojë prokurorit ushtrimin e kompetencave ose t’i paraqesë kërkesa drejtpërdrejt gjykatës kompetente.

Neni 69

Detyrat e prokurorit

Prokurori duhet të mbikëqyrë drejtpërdrejt, periodikisht ose pa paralajmërim institucionet e

ekzekutimit të dënimeve me burgim, duke u shoqëruar, kur është rasti, nga specialistë të fushave përkatëse.

Për konstatimet dhe për parregullsitë apo pengesat në drejtim të kompetencës së tij të mbikëqyrjes, prokurori, paraqet kërkesë te drejtori i institucionit për rivendosjen e menjëhershme të ligjit apo rregullit të shkelur, për realizimin e së drejtës së të dënuarit, si dhe nisjen e procedimit disiplinor, administrativ apo të zhdëmtimit ndaj shkaktarëve, përveç kur është vendi për procedim penal.

Kur kërkesa e prokurorit nuk merret në konsideratë dhe në të gjitha rastet kur rivendosja e ligjit, rregullit apo e së drejtës të shkelur është kompetencë e gjykatës sipas kësaj ligje ose organeve të tjera kompetente, çështja u paraqitet atyre për shqyrtim.

Neni 70

Format e mbikëqyrjes së prokurorit

Mbikëqyrja realizohet nëpërmjet:

1. marrjes dhe evidentimit të njoftimit për ekzekutimin e vendimit me burgim nga administrata e institucionit;

2. pranimit të ankesave dhe kërkesave nga të dënuarit, me shkrim ose drejtpërdrejt;

3. marrjes së informacionit, ankesave dhe kërkesave të të dënuarve, kërkesave të Këshillit të Mbikëqyrjes ose nga persona që kanë statusin e vizitorit, sipas nenit 41 të këtij ligji ose të organeve shtetërore apo organizatave jo qeveritare, të cilat kanë kontrolluar apo vizituar institucionin sipas kompetencës që u njeh ligji ose me autorizim, si dhe nga avokati i të dënuarit;

4. kërimit të informacioneve nga administrata e institucionit;

5. verifikimit mbi dokumente, në objekte, pajisje dhe mjedise brenda dhe jashtë institucionit, që kanë lidhje me të dënuarit. Kur është vendi, bëhen verifikime edhe në vetë personin e dënuar ose punonjësve të institucionit.

Për realizimin e mbikëqyrjes prokurori mund të marrë edhe specialistë të fushave përkatëse.

Në çdo rast dhe pavarësisht nëse konstatohen shkelje e parregullsi, gjatë verifikimit, prokurori mban procesverbal, i cili nënshkruhet nga drejtori i institucionit ose i ngarkuari prej tij, me të drejtën e pasqyrimin të observacioneve.

Neni 71

Kompetencat e gjykatës

Gjykata, në territorin e së cilës ndodhet institucioni, shqyrton me një gjyqtar të gjitha rastet që përcaktohen shprehimisht në këtë ligj, si dhe çështje të tjera që kanë të bëjnë me të drejtat e të dënuarit, të cilat nuk janë zgjidhur nga institucioni mbi ankimin e të dënuarit ose kërkesës së prokurorit, me përjashtim të çështjeve për të cilat në Kodin e Procedurës Penale është përcaktuar kompetenca.

Neni 72

Shqyrtimi i çështjes nga gjyqtari

Gjyqtari shqyrton çështjen dhe merr vendime vetëm përse është ankuar ose kërkuar në seancë gjyqësore me pjesëmarrje të detyrueshme të drejtorit të institucionit ose përfaqësuesit të tij dhe prokurorit. Kur çështja nuk mund të shqyrtohet pa praninë e të dënuarit, seanca zhvillohet në mjedise të përshtatshme të institucionit ku ndodhet.

Në shqyrtimin e çështjes merr pjesë edhe avokati i kërkuar nga i dënuari ose i caktuar kryesisht për të dënuarit e mitur, ata që kanë shqetësime psikike, gratë me barrë ose fëmijë në gji, si dhe të dënuarit me shtetësi të huaj.

Kërkesat ose ankimet e pabazuara ose të përsëritura për të njëjtat raste e shkaqe, refuzohen. Kundër vendimit, i dënuari, drejtori i institucionit dhe prokurori, mund të bëjnë ankesë në gjykatë brenda 5 ditëve nga vënja në dijeni.

Ankesa e të dënuarit dhe drejtorit nuk e pezullon ekzekutimin e vendimit. Kur ankimi është bërë nga prokurori, ekzekutimi bëhet vetëm pas shqyrtimit të çështjes nga gjykata.

Neni 73

Shqyrtimi i ankimeve

Gjykata shqyrton ankimet sipas rregullave të shqyrtimit të çështjeve në shkallë të dytë. Kur vendoset prishja e vendimit çështja shqyrtohet në çdo rast në themel dhe vendoset përfundimisht me vendim të formës së prerë.

Neni 74

Ekzekutimi i vendimeve

Vendimet ekzekutohen kryesisht nga drejtori i institucionit dhe, kur nuk veprohet prej tij me plotësimin e afatit të caktuar në vendim, me urdhër të prokurorit nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve.

DISPOZITA TRANSITORE DHE TË FUNDIT

Neni 75

Zbatimi i ligjit ndaj të arrestuarit dhe të ndaluarit

Dispozitat e këtij ligji zbatohen edhe ndaj të arrestuarve dhe të ndaluarve, duke respektuar kufizimet e vendosura për ta me ligje të tjera.

Neni 76

Aktet nënligjore zbatuese

Këshilli i Ministrave miraton rregulloren e burgjeve dhe aktet e tjera nënligjore në zbatim të këtij ligji brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e tij.

Rregulloret e brendshme të çdo institucioni miratohen nga Ministri i Drejtësisë, brenda 1 muaji nga hyrja në fuqi e rregullores së burgjeve.

Ministri i Drejtësisë në zbatim të ligjit dhe rregullores së burgjeve nxjerr urdhrat dhe udhëzimet e nevojshme.

Deri në daljen e akteve nënligjore në zbatim të këtij ligji, mbeten në fuqi ato ekzistuese.

Neni 77

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2076, datë 30.4.1998 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani